

Në bazë të nenit 17 paragrafi (7) të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014, 199/2014 , 27/2016, 35/2018, 198/2018), dhe nenit 28 paragrafi (2) pika 5 dhe nenit 36 të Ligjit për kulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 15/2008, 116/2010, 47/2011, 51/2011, 136/2012, 23/2013, 44/2014, 61/2015, 154/2015, 39/2016, 11/2018 dhe 11/2018), u.d drejtori i Institucionit Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, miratoi

RREGULLORE

për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup

Neni 1

Me këtë rregullore bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores nr. 02-248/3 nga data 09.09.2020 për sistematizimin e vendeve të punës në IN Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, Rregullores nr. 01-40/1 nga 15.01.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin nacional, Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup dhe Rregullores nr. 01-223/1 nga 23.07.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup dhe Rregullores nr. 01-37/1 nga 16.01.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup dhe atë:

Neni 2

Në Nenin 6 të Rregullores në Pasqyrën tabelore të vendeve të punës nëpunës administrativë pjesa numri i realizuesve të sistematizuar në vendet e punës nëpunës administrativë ndryshohet dhe atë:

- niveli V2 numri i realizuesve të sistematizuar 3 ndryshohet dhe bëhet 2 realizues të sistematizuar;
- niveli V4 numri i realizuesve të sistematizuar 3 ndryshohet dhe bëhet 2 realizues të sistematizuar;
- niveli G4 numri i realizuesve të sistematizuar 1 ndryshohet dhe bëhet 0 realizues të sistematizuar;

Neni 3

Neni 7 i Rregullores në Pasqyrën tabelore të vendeve të punës ofrues të shërbimeve, pjesa numri i realizuesve të sistematizuar të vendeve të punës ofrues të shërbimeve ndryshohet dhe atë:

- niveli D1 numri i realizuesve të sistematizuar 1 ndryshohet dhe bëhet 2 realizues të sistematizuar;
- niveli D3 numri i realizuesve të sistematizuar 2 ndryshohet si vijon 1 realizues të sistematizuar;
- niveli G2 numri i realizuesve të sistematizuar 1 ndryshohet dhe bëhet 5 realizues të sistematizuar;
- niveli G3 numri i realizuesve të sistematizuar 5 ndryshohet dhe bëhet 4 realizues të sistematizuar;

Neni 4

Në nenin 8 të Rregullores në Pasqyrën tabelore të vendeve të punës persona ndihmës-teknik, pjesa numri i realizuesve të sistematizuara të vendeve të punës persona ndihmës-teknik ndryshohet dhe atë:

- niveli A1 numri i realizuesve të sistematizuar 1 ndryshohet dhe bëhet 2 realizues të sistematizuar;
- niveli B2 numri i realizuesve të sistematizuar 7 ndryshohet dhe bëhet 6 realizues të sistematizuar;
- niveli B1 numri i realizuesve të sistematizuar 10 ndryshohet dhe bëhet 9 realizues të sistematizuar;

Neni 5

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin profesional për identifikim, mbrojtje, revitalizim, prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë së tundshme kulturore, në Seksionin e ekspozitës, pas vendit të punës me numër rendor 3 me emër Kustos i lartë, me shifër КУЛ 03 04 Д02 002, me titull Kustos i lartë, shtohet vend i ri i punës me numër rendor 3A si vijon:

SEKTORI PROFESIONAL PËR IDENTIFIKIM, MBROJTJE, REVITALIZIM, PREZANTIM DHE POPULLARIZIM TË TRASHËGIMISË SË TUNDSHME KULTURORE	
SEKSIONI I EKSPOZITËS	
Numri rendor	3A
Shifra	КУЛ 03 04 Д01 002
Niveli	D1
Titulli i vendit të punës	Kustos këshilltar
Emri i vendit të	Kustos këshilltar

punës	
Numri i realizuesve	1
Lloji i arsimit	Shkenca humaniste dhe arte (Historia e artit)
Kushte tjera të veçanta	
Qëllimet e punës	Mbrojtje, prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë të tundshme kulturore
Detyra dhe obligime të punës	• udhëheq në mënyrë të pavarur me koleksionin e sendeve muzeore, kryen hulumtim në kabinet dhe terren, mbledh dhe rregullon në mënyrë të pavarur material muzeor dhe sende muzeore, kujdeset dhe e monitoron gjendjen e sendeve muzeore dhe materialit muzeor • Bën përpunimin dhe studimin profesional dhe shkencor, mbron, publikon dhe prezanton material dhe sende muzeore, kujdeset dhe e monitoron gjendjen e sendeve muzeore dhe materialit muzeor; • udhëheq me projekte, hulumtime sistemore dhe gjurmime për të cilat kryen përgatitje të përgjithshme, organizim, udhëheqje të drejtpërdrejtë, monitorim të procesit të hulumtimit dhe përpunim të dokumentacionit, përpunim profesional i rezultateve dhe raporteve; • kryen ekspertizë dhe vlerësim të dëmit të mirave të mbrojtura të tundshme. • përgatit elaborate për ri(vlerësim) të trashëgimisë së luajtshme kulturore dhe propozime për miratimin e aktit për mbrojtje të saj; • punon në përgatitjen e vendekspozitës së përhershme muzeore (koncept, kep propozime për organizim) dhe realizimit; • merr pjesë në përgatitjen e ekspozitave të përkohshme; • merr pjesë në përpunimin e projekteve për konservim dhe restaurim të trashëgimisë së tundshme kulturore; • kryen revizion të sendeve muzeore dhe përgatit ose merr pjesë në përgatitjen e raporteve nacionale për aplikim të standardeve ndërkombëtare në punën e muzeut dhe merr pjesë në mbledhjet profesionale. • merr pjesë në programet për edukim dhe marketing muzeor, merr pjesë në realizimin e projekteve tjera dhe kryen popullarizimin e aktiviteteve muzeore.
Përgjigjet para	Udhëheqësit të Sektorit për identifikim, mbrojtje, revitalizim,

	prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë së tundshme kulturore
--	--

Neni 6

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin profesional për identifikim, mbrojtje, revitalizim, prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë së tundshme kulturore, në Seksionin për depo, dokumentacion dhe konservim, vend pune me numër rendor 4 me emër Kustos, në Seksionin për depo, dokumentacion dhe konservim, me shifër КУЛ 03 04 Д03 002, me titull Kustos në Seksionin për depo, dokumentacion dhe konservim, pjesa numri i realizuesve: numri i realizuesve: numri 2 zëvendësohet me numrin 1.

Neni 7

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin nacional, Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin profesional për identifikim, mbrojtje, revitalizim, prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë së tundshme kulturore, në Seksionin për dizajn dhe marketing, pas vendit të punës me numër rendor 11 me emër Bashkëpunëtor i artit magjistër, me shifër КУЛ 03 04 Г02 005, me titull Bashkëpunëtor profesional për arte vizuale, dizajn dhe arkitekturë, shtohet vend i ri pune me numër rendor 11A si vijon:

SEKTORI PËR IDENTIFIKIM, MBROJTJE, REVITALIZIM, PREZANTIM DHE POPULLARIZIM TË TRASHËGIMISË SË TUNDSHME KULTURORE	
Seksioni për dizajn dhe marketing	
Numri rendor	11A
Shifra	КУЛ 03 04 Г02 005
Niveli	G2
Titulli i vendit të punës	<i>Bashkëpunëtor profesional për arte vizuale, dizajn dhe arkitekturë</i>
Emri i vendit të punës	Bashkëpunëtor i artit
Numri i realizuesve	2
Lloji i arsimit	Shkencat humaniste dhe arte – Arte (arti) ose arsim të kryer të artit ose arsim të mesëm profesional
Kushte tjera të veçanta	
Qëllimet e punës	Mbrojtje të trashëgimisë kulturore
Detyra dhe obligime	kryen në mënyrë profesionale punët e formësimit

të punës	figurativ profesional dhe përgatit materialet e shtypura (katalogët, pllakatet dhe publikimet) që i boton Galeria përmes programeve ILLUSTRATOR, INDESIGN dhe PHOTOSHOP; • përgatit emblemë të galerisë (logo) ; • bashkëpunon me seksione tjera ; • propozon dhe përgatit ide për ndryshimin e enterierit të Galerisë në bashkëpunim me persona tjerë profesionalë ; • bashkëpunon me shtypshkronjën dhe firmat tjera jashtë Galerisë sipas nevojës së detyrave të punës e cila është dhënë.
Përgjigjet para	Udhëheqësit të Sektorit për identifikim, mbrojtje, revitalizim, prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë së tundshme kulturore

Neni 8

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin profesional për identifikim, mbrojtje, revitalizim, prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë së tundshme kulturore, në Seksionin për dizajn dhe marketing, pas vendit të punës me numër rendor 12 me emër Bashkëpunëtor Figurativ, me shifër KYЛ 03 04 Г03 005, me titull Bashkëpunëtor për arte vizuale, dizajn dhe arkitekturë, shtohet vend i ri pune me numër rendor 12A si vijon:

SEKTORI PËR IDENTIFIKIM, MBROJTJE, REVITALIZIM, PREZANTIM DHE POPULLARIZIM TË TRASHËGIMISË SË TUNDSHME KULTURORE	
Seksioni për dizajn dhe marketing	
Numri rendor	12A
Shifra	KYЛ 03 04 Г02 005
Niveli	G2
Titulli i vendit të punës	<i>Bashkëpunëtor profesional për arte vizuale, dizajn dhe arkitekturë</i>
Emri i vendit të punës	Bashkëpunëtor i artit
Numri i realizuesve	1
Lloji i arsimit	Shkencat humaniste dhe arte – Arte (arti) ose arsim të kryer të artit ose arsim të mesëm profesional
Kushte tjera të veçanta	
Qëllimet e punës	Mbrojtje të trashëgimisë kulturore
Detyra dhe obligime	• i fotografon në mënyrë profesionale dhe i përpunon në

të punës	kompjuter fotografitë, pllakatet dhe publikimet që i boton Galeria kryen punët e formësimit figurativ të katalogëve, pllakateve dhe publikimeve) që i boton Galeria; i përgatit materialet e nevojshme për prezantim elektronik të aktiviteteve të galerisë; përgatit emblemë të Galerisë; është i pranishëm në të gjitha manifestimet dhe hapjet e ekspozitave në Galerinë dhe i fotografon dhe bën album nga hapja e ekspozitave dhe manifestimeve tjera; bashkëpunon me seksionet tjera të Galerisë;
Përgjigjet para	Udhëheqësit të Sektorit për identifikim, mbrojtje, revitalizim, prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë së tundshme kulturore

Neni 9

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin Nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin profesional për identifikim, mbrojtje, revitalizim, prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë së tundshme kulturore, në Seksionin për dizajn dhe marketing, vendi i punës me numër rendor 13 me emër Bashkëpunëtor i artit fotograf, në Seksionin për dizajn dhe marketing, me shifër KYЛ 03 04 Г02 005, me titull Bashkëpunëtor për arte vizuale, dizajn dhe arkitekturë, pjesa numri i realizuesve: numri 2 zëvendësohet me numrin 1.

Neni 10

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin profesional për identifikim, mbrojtje, revitalizim, prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë së tundshme kulturore, në Seksionin për dizajn dhe marketing, pas vendit të punës me numër rendor 13 me emër Bashkëpunëtor i artit – fotograf, me shifër KYЛ 03 04 Г03 005, me titull Bashkëpunëtor për arte vizuale, dizajn dhe arkitekturë, shtohet vend i ri i punës me numër rendor 14A si vijon:

SEKTORI PËR IDENTIFIKIM, MBROJTJE, REVITALIZIM, PREZANTIM DHE POPULLARIZIM TË TRASHËGIMISË SË TUNDSHME KULTURORE	
Seksioni për dizajn dhe marketing	
Numri rendor	14 A
Shifra	KYЛ 03 04 Г02 005
Niveli	G2
Titulli i vendit të punës	<i>Bashkëpunëtor profesional për arte vizuale, dizajn dhe arkitekturë</i>
Emri i vendit të	Disenjator

punës	
Numri i realizuesve	1
Lloji i arsimit	Shkencat humaniste dhe arte – Shkenca tjera humaniste Etnologji, ose arsim të kryer të artit ose arsim të mesëm profesional
Kushte tjera të veçanta	
Qëllimet e punës	Mbrojtja e trashëgimisë kulturore
Detyra dhe obligime të punës	• E koncepton, përditëson dhe përplotëson faqen zyrtare të Institucionit. Të njëjtën e plotëson me informacione aktuale për evenimente dhe ngjarje, si dhe plotëson bazën e të dhënave dhe faktografinë e Institucionit, strukturën dhe historinë e saj. • Publikon informacione publike dhe dokumente të cilat sipas ligjit janë informacione të karakterit publik dhe obligime të institucionit për punën transparente; • Përpunon prezantime të shkurtra me foto dhe video për në rrjetet sociale me karakter promovues. Shkruan tekste promovuese dhe informative lidhur me prezantimin e vetë Institucionit para publikut; • Merr pjesë me ide dhe propozime kreative me kolegët në Seksionin gjatë konceptimit të zgjidhjeve kreative dhe promovuese lidhur me ekspozitat, ngjarjet dhe identitetin e përgjithshëm vizual të vetë Institucionit; • Është i pranishëm në të gjitha manifestimet, hapjet e ekspozitave në Galerinë; • Bashkëpunon me seksione tjera në Galerinë;
Përgjigjet para	Udhëheqësit të Sektorit për identifikim, mbrojtje, revitalizim, prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë së tundshme kulturore

Neni 11

Në pjesën Pasqyrë tabelore e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike dhe financiare, në Seksionin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike, pas vendit të punës me numër rendor 16A me emër Bashkëpunëtor i lartë për resurse njerëzore, me shifër KYЛ 0102 B02 010, me titull Bashkëpunëtor i lartë për resurse njerëzore, shtohet vend i ri pune me numër rendor 16B si vijon:

1. SEKTORI PËR ÇËSHTJE JURIDIKE, ADMINISTRATIVE, TË
--

PËRGJITHSHME TEKNIKE DHE FINANCIARE	
Seksioni për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike	
Numri rendor	165
Shifra	KYЛ 0102 B02 009
Niveli	B2
Titulli i vendit të punës	Bashkëpunëtor i lartë për marketing dhe marrëdhënie me publikun
Emri i vendit të punës	Bashkëpunëtor i lartë për marketing dhe marrëdhënie me publikun
Numri i realizuesve	1
Lloji i arsimit	Shkenca humaniste dhe arte – Shkenca tjera humaniste Arti (arte)
Kushte tjera të veçanta	-
Qëllimet e punës	Mbrojtje aktive, efektive dhe efikase të trashëgimisë kulturore
Detyra dhe obligime të punës	• E planifikon marketingun e Galerisë; • Kontakton dhe bashkëpunon me forma të interesuara; • I ndjek dhe i dokumenton aktivitetet jashtëprogramore (koncertet, promocionet etj.) që realizohen në Galerinë; kontakton me mediat për aktivitetet rrjedhëse të Galerisë; • Ndhmon gjatë përgatitjes së materialeve të nevojshme për konferencën e shtypit të Galerisë; • I përgatit teknikisht informacionet për mediat, krijon në mënyrë të pavarur zgjidhje vizuale, e formëson imazhin e sendit të gjetjes, duke mbajtur llogari për kanalet e komunikimit dhe ndikimin e tyre në pajtim me qëllimet e përcaktuara. • i harmonizon dhe i balancon përfitimet dhe mangësitë e çdo kanali varësisht nga publiku i përfshin mediat sociale, ueb lokacionin, podkastet dhe vdeot; • Përgatit materiale për publikim të mediave sociale dhe gjatë formësimit të gjetjeve informative dhe zgjidhjeve grafike intervenon në materialet me ndihmën e mjeteve nga dizajni grafik për ekstension adekuat për medium të dhënë, respektim dhe aplikim të rregullt të logotipive, titujve të projekteve dhe elementeve tjera informative në

	çdo gjetje. • E përditëson dhe përtërin vazhdimisht listën protokollare të Galerisë dhe mban llogari për saktësinë e të dhënave të shënuara në të;
Përgjigjet para	Udhëheqësit të Sektorit për çështje juridike, administrative dhe të përgjithshme

Neni 12

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin Nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup, në Sektorin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike dhe financiare, në Seksionin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike, vendi i punës me numër rendor 22 me emër Arkivist ndihmës, me shifër KUL 01 02 G04 007, me titull Referent i ri për evidencë kadrovike me numër të realizuesve.. 1. fshihet.

Neni 13

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike dhe financiare, në Seksionin për prokurime publike vendi i punës me numër rendor 30 me emër Bashkëpunëtor i ri për çështje informatike, me shifër KYЛ 04 01 B04 004 me titull Bashkëpunëtor i ri për çështje informatike, me numër të realizuesve 1 fshihet.

Neni 14

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike dhe financiare, në Seksionin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike vendi i punës me numër rendor 16 me emër Bashkëpunëtor i lartë për çështje administrative, të përgjithshme dhe juridike, me shifër KYЛ 01 02 B02 002 me titull Bashkëpunëtor i lartë për çështje administrative, të përgjithshme dhe juridike, me numër të realizuesve 1 fshihet.

Neni 15

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike dhe financiare, në Seksionin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike, vendi i punës me numër rendor 17 me emër Teknik muzeor, me shifër KYЛ 04 01 A01 010, me titull Teknik muzeor, pjesa numri i realizuesve: numri 1 zëvendësohet me numrin 2.

Neni 16

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve në Institucionin nacional Galeria Nazionale e Republika e Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike dhe financiare, në Seksionin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike, vendi i punës me numër rendor 25 me emër Higjienist, me shifër KYЛ 04 01 Б02 01 005 me titull Punëtor tjetër për mirëmbajtje të objekteve, në pjesën numri i realizuesve: numri 5 zëvendësohet me numrin 4.

Neni 17

Në pjesën Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin nacional, Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike dhe financiare, në Seksionin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike dhe financiare, në Seksionin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike, vendi i punës me numër rendor 26 me emërtim Rojtar kontrollor, me shifër KYЛ 04 01 Б01 01 004 me titull Punëtor tjetër për pranim të vizitorëve, në pjesën e numrit të realizuesve: numri 10 zëvendësohet me numrin 9.

Neni 18

Në pajtim me ndryshimet e kryera në tekstin integral të Rregullores, bëhen ndryshime dhe plotësime edhe në Pasqyrën tabelore, që është dorëzuar si Shtojcë e kësaj Rregulloreje.

Neni 19

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e miratimit, ndërsa do të aplikohet pas pëlqimit të marrë me shkrim nga Bordi Drejtues i IN Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup dhe Ministria e Administratës Publike.

U.D DREJTOR

Maja Nedellkoska-Bërzanova

Numri arkivor:

Data:

SHTOJCË**4. PASQYRA TABELORE E VENDEVE TË PUNËS**

Nr. rend.	Shifra	Emërtimi i Titulli i vendit të punës	Numri i sistem. të vend. të pun.	Numri i vendeve të plotësuara		
				Nëpunës administrativ	Ofrues të shërbimeve	Ndihmës teknik
1	КУЛ 03 04 Д01 005	Udhëheqës i Sektorit – Udhëheqës i Njesisë së brendshme organizative – Sektori në bibliotekë/muze/Qendër në Konservim/kinotekë	1			
2	КУЛ 03 04 Д03 002	Kustos në seksionin e ekspozitës – Kustos	3		3	
3	КУЛ 03 04 Д02 002	Kustos i lartë në Seksionin e ekspozitës – Kustos i lartë	3		3	
3A	КУЛ 03 04 Д02 002	Kustos i lartë në Seksionin e ekspozitës – Kustos këshilltar	1			
4	КУЛ 03 04 Д03 002	Kustos në Seksionin për depo, dokumentacion dhe konservim-Kustos	1		1	
5	КУЛ 03 04 Д02 002	Kustos i lartë në Seksionin për depo, dokumentacion dhe konservim – Kustos i lartë	2		2	
6	КУЛ 03 04 Д03 003	Konservator - Konservator	1		1	
7	КУЛ 03 04 Д02 003	Konservator i lartë– Konservator i lartë	1		1	
8	КУЛ 03 04 Д03 007	Ciceron – Ciceron	1		1	
9	КУЛ 03 04 Д03 006	Edukator-Edukator	3		3	
10	КУЛ 03 04 Г01 005	Bibliotekar – Ndihmës i pavarur i bibliotekës	1		1	
11	КУЛ 03 04 Г02 005	Bashkëpunëtor magjistër i artit – Bashkëpunëtor profesional për arte pamore, dizajn dhe arkitekturë	1		1	

11A	КУЛ 03 04 Г02 005	Bashkëpunëtor i artit – Bashkëpunëtor profesional për arte pamore, dizajn dhe arkitekturë	2			
12	КУЛ 03 04 Г03 005	Bashkëpunëtor i artit – Bashkëpunëtor për arte pamore, dizajn dhe arkitekturë	2		2	
12A	КУЛ 03 04 Г02 005	Bashkëpunëtor i artit – fotograf - Bashkëpunëtor profesional për arte pamore, dizajn dhe arkitekturë	1			
13	КУЛ 03 04 Г03 005	Bashkëpunëtor i artit – fotograf - Bashkëpunëtor për arte pamore, dizajn dhe arkitekturë	1		1	
13A	КУЛ 03 04 Г02 005	Disenjator - Bashkëpunëtor profesional për arte pamore, dizajn dhe arkitekturë	1			
14	КУЛ 03 04 Г03 005	Disenjator – Bashkëpunëtor për arte pamore, dizajn dhe arkitekturë	1		1	
15	КУЛ 01 02 Б02 001	Sekretar – Udhëheqës i Sektorit për çështje administrative, të përgjithshme dhe juridike	1	1		
16						
16A	КУЛ 0102 Б02 010	Bashkëpunëtor i lartë për resurse njerëzore – Bashkëpunëtor i lartë për resurse njerëzore	1	1		
16Б	КУЛ 01 02 Б02 010	Bashkëpunëtor i lartë për marrëdhënie me publikun dhe marketing – Bashkëpunëtor i lartë për marrëdhënie me publikun dhe marketing	1			

17	КУЛ 04 01 А01 010	Teknik i muzeut – Teknik i muzeut	2			1
18	КУЛ 01 02 В04 003	Bashkëpunëtor i ri për bashkëpunim ndërkombëtar (Përkthyes) – Bashkëpunëtor i ri për bashkëpunim ndërkombëtar	1	1		
19	КУЛ 01 02 В04 010	Marrëdhënie me publikun dhe marketing – Bashkëpunëtor për marketing dhe marrëdhënie me publikun	1	1		
20	КУЛ 01 02 Г01 001	Sekretar teknik – Referent i pavarur për çështje administrative	1	1		
21	КУЛ 01 02 Г01 009	Arkivist ekonom – Arkivist	1	1		
22		Referent i ri – Referent i ri për evidencë kadrovike				
23	КУЛ 01 02 В02 001		1			1
24	КУЛ 0401 В02 004	Mjeshtër universal - Mjeshtër universal	1			1
25	КУЛ 04 01 В02 005	Magaziniër – Magaziniër	4			4
26	КУЛ 04 01 В01 004	Higjienist – Punëtor për mirëmbajtje të objekteve	9			9
27	КУЛ 01 02 В04 002	Rojtar kontrollor – Punëtor për pranimin e vizitorëve	1	1		
28	КУЛ 01 02 Г01 004	Kontabilist përgjegjës – Udhëheqës i seksionit për kontabilitet	1	1		
28A	КУЛ 01 02 В04 003	Arkëtar – Referent i pavarur – kryearkëtar	1	1		
29	КУЛ 01 02 В01 004	Udhëheqës i Seksionit për prokurime publike – Udhëheqës i Seksionit për çështje materiale-	1	1		

		financiare				
30						
	GJITHSEJ		55	10	21	16

U.D DREJTOR

Maja Nedellkoska-Bërzanova

Numri arkivor:

Data: